



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PËRKUJTIMORE TË KUVENDIT TË KOSOVËS ME
RASTIN E SHËNIMIT TË 14-VJETORIT TË ZHDUKUJES SË
ATDHETARIT DHE DIPLOMATIT TË SHQUAR TË ÇËSHTJES
KOMBËTARE UKSHIN HOTI, E MBAJTUR MË 17 MAJ 2013**

**SA SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
POVODOM OBELEŽAVANJA 14. GODIŠNJICE NESTANKA
ISTAKNUTOG RODOLJUBA I DIPLOMATA NACIONALNOG
PITANJA UKSHIN HOTI, ODRŽANE 17. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Mbledhjen përkujtimore e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar familjarë të Ukshin Hotit,
Të nderuar familje të dëshmorëve,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në këtë seancë përkujtimore me rastin e 14-vjetorit të humbjes pa gjurmë të atdhetarit, diplomatit të shquar të çështjes kombëtare, Ukshin Hoti.

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Në emër të deputetëve, fjalën e ka kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Të nderuar familjarë të Ukshin Hotit,
Seanca e sotme e Kuvendit të Republikës së Kosovës i kushtohet një figure të veçantë të kombit shqiptar.
Ukshin Hoti, burri i madh i Kosovës, tridhjetë e dy vjet më parë, midis furtunës shoviniste u ngrit si Anteu, duke u bërë përfaqësuesi më i denjë i shtresës intelektuale të vendit dhe popullit të vet.

I ndërgjegjshëm për rreziqet dhe pasojat që do të kishte, ai doli hapur në mbrojtje të të drejtave legjitime dhe të kërkesave të qindra-mijëra demonstruesve, të cilët nën parullën “Kosova Republikë!” ndesheshin nëpër barrikada dhëmb për dhëmb me forcat e errëta kriminale të pushtuesit barbar.

Ukshin Hoti u bë shembulli i shkëlqyer i intelektualit vetëmohues dhe besnik të interesave jetike të popullit të vet.

Këtu e katërmëdhjetë vjet më parë, delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë i mungonte një anëtar. Gjatë gati një muaj e gjysmë, sa zgjati konferenca, karrigia ngeli e zbrazët, pasi i zoti i saj, Ukshin Hoti, mbahej në burg nga regjimi pushtues, duke u pamundësuar kështu pjesëmarrja e tij në bisedime.

Qartësia politike dhe mendimi i thellë, logjika e hekurt dhe fuqia argumentuese, guximi intelektual dhe vullneti i pathyeshëm i Ukshin Hotit i mungonte Kosovës në çastet vendimtare e historike për fatin e saj.

Mendja e ndritur e Ukshin Hotit i mungonte luftës çlirimtare të Kosovës, sepse regjimi e mbante në kazamatet e tij për të dytën herë, me shumë vite burg, për t’ia ndaluar veprimtarinë dhe mbase për t’ia marrë jetën. Por, Ukshin Hoti e kishte një ideal, jetonte për një ideal dhe luftonte për një ideal, të cilin nuk mund ta vritnin, as mund ta ndalnin.

Ukshin Hoti vazhdon t'i mungojë ndjeshëm dhe tmerrshëm Kosovës, Kosovës së tij që aq shumë e deshi dhe që aq shumë bëri për të. Nëna Kosovë nuk di tash e katërmëdhjetë vjet për birin e saj të madh, Ukshin Hoti: është syrgjyn gjallë, apo syrgjyn vdekur? Bota intelektuale nuk di për dijetarin e kalibrit universal; bota çlirimtare nuk di për luftëtarin e paepur të lirisë, e bota demokratike nuk di për demokratin e humanistin e madh.

Ku është Ukshin Hoti, thërret e duhet të thërrasë më fuqishëm zëri i ndërgjegjes njerëzore.

Edhe ne sot, të mbledhur këtu, ku padrejtësisht mungon Ukshin Hoti, të mbledhur për ta nderuar figurën dhe personalitetin e tij prej atdhetari dhe intelektual të shquar, pyesim me zë të lartë dhe protestues: Ku është Ukshini ynë?

Faleminderit për vëmendje!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj deputetin Idriz Vehapi që, në përfaqësim të propozuesit, ta marrë fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeminsitra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Shumë e respektuar Familja Hoti,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

Të nderuar miq të Ukshin Hotit,

Më lejoni që fjalën time ta nis me një biografi të shkurtër të Ukshin Hotit. Ukshin Hoti ka lindur më 17 qershor 1943, në Krushë të Madhe të Rahovecit. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Prizren dhe në Prishtinë. Shkencat politike i kreu në Zagreb, kurse 2 vite pasuniversitare i kreu në Beograd, në Seksionin për Marrëdhënie Ndërkombëtare Politike dhe Ekonomike. Pastaj specializoi një vit edhe në universitetet amerikane: në Çikago, në Universitetin e Harvardit në Boston, si dhe në Uashington D.C.

Në vitet e '70-ta ishte në pozita të ndryshme të jetës politike dhe arsimore të Kosovës.

Më 19 nëntor 1981, pas një diskutimi në një mbledhje në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, ku ai hapur i mbrojti kërkesat e studentëve shqiptarë për Republikën e Kosovës u dënua me 9 vjet burg, duke vijuar më pastaj që të gjykohej edhe në tri procese të tjera gjyqësore.

Një intelektual që sapo lirohej, merrej prapë në burg, duke ndërruar qelitë si këmishët e trupit.

Pas lirimit nga burgu u kthye në vendlindje me statusin e njeriut të izoluar. Më 1990 punoi në Lubjanë të Sllovenisë, në revistat shqiptare “Alternativa”, “Republika” dhe “Demokracia Autentike”, si redaktor deri më 1991, kur u mbyllën ato.

Në mars të vitit 1993 u burgos për herë të dytë, pasi një vit më parë kishte organizuar homazh për martirët e demokracisë në fshatin Brestoc të Rahovecit.

Më 17 maj 1994, prapë u dënua me 5 vjet burg. Më 16 maj 1999 kishte mbaruar afati i vuajtjes së dënimit politik prej 5 vjetësh. Të burgosurit shqiptarë dëshmojnë se në përcjellje të tre zyrtarëve të sigurimit serb atë ditë ai është nxjerrë nga Burgu i Dubravës në Istog, ku ishin sjellë më parë të burgosurit shqiptarë nga Burgu i Nishit.

Pas bombardimeve të NATO-s, më 19 maj 1999, në Burgun e Dubravës ka ndodhur masakra më e përgjakshme, me ç’rast janë ekzekutuar e masakruar 173 të burgosur shqiptarë nga forcat serbe, ndërsa për fatin e profesor Ukshin Hotit prej asaj kohe, pra prej vitit 1999, nuk dihet më asgjë.

Ukshin Hoti është autor i dy librave të botuar në fushën e mendimit politik: “Lufta e ftohtë dhe detanti”, në vitin 1975, dhe “Filozofia politike e çështjes shqiptare”, 1995.

Ukshin Hoti është i zhdukur në rrethana misterioze nga forcat e shtetit okupues serb, për të cilin pandehim - dhe lutemi, për të qenë gjallë, ndërsa që ne kur flasim për të përplasemi me dhembje e dyshim - të themi, në kuptimin e të qenët gjallë në këtë botë - Ukshin Hoti ishte, apo Ukshin Hoti është... Ne lutemi për të, siç lutemi edhe për mijëra shqiptarë të zhdukur, për të cilët ende nuk dimë gjë.

Ukshin Hoti është intelektual i konsekuent i profilit në mendimin bashkëkohor në Kosovë. Mendimi i tij politik është koherent dhe vepra e tij sot lexohet si e një profetiku në kuptimin e parashikimeve që i bëri për të ardhmen e ish-Jugosllavisë, por edhe për fatin e të ardhmen e Kosovës.

Ai është intelektual i shkrimit dhe i bisedës. Po të ishin të regjistruara do ta përbënin një vëllim shumë herë më të madh se vetë librat e tij të shkruara. Pra, të folurit e tij ishte ndoshta konsistent e sistematik, sa edhe vetë shkrimi, siç i njeh historia e kulturës njerëzore intelektualët e tillë me zë dhe me fat të tillë që kanë shkruar pak në krahasim me fuqinë intelektuale që kishin.

Ukshin Hoti është intelektual që asnjë fuqi represive nuk ia mbylli dot gojën. Një njeri që ishte në një betejë të fuqishme të mendimit dhe i cili e pati fatin që të mos mund t’u shmangej vlerësimeve që krijoheshin për të, si intelektual problematik, tej mase i guximshëm, i paparashikueshëm, që nuk i bishtnon asnjëherë mendimit, ndërsa që nga shteti serb konsiderohej si njeri që shteti mund të rrijë më i qetë kur ai të jetë në burg.

Kujtojmë se ai përjetoi 4 procese gjyqësore dhe mbajti disa vjet burg në regjimin jugosllav e serb dhe kur lirohej nga burgu prapë i imponohej izolimi. Një intelektual që e

flijoi lirinë e vet dhe të mirat e veta, që mund t'i vinin prej dijetari, që është në kërkime e në qetësinë akademike për idealin dhe ëndrrën shqiptare për liri e pavarësi.

Ishte prej intelektualëve më të guximshëm që ka njohur Kosova, i cili i sfidonte bashkëkohësit e vet me mendimin e tij të padruajtur. Një njeri i vetmuar, ndaj të cilit u zhvillua një luftë e vërtetë psikologjike kundër tij, nga mekanizmat e shtetit e të pushtetit jugosllav dhe serb, e çuditërisht, siç thoshte edhe vetë - askush nuk e mbronte në mënyrë të hapur.

Duke qenë trim përballë regjimit represiv serb dhe një opozitar i fort në ide brendapërbrenda nesh në shoqërinë e Kosovës, ai u bë një intelektual jo i zakonshëm.

Ukshin Hoti ishte intelektual që thotë me tension e presion: zbatoje misionin e të qenët i lirë; bëhu i lirë edhe nëse nuk je, mendo dhe fol e shkruaj mos u ndal, për ta mundur represionin e terrorin, i çfarëdo përmase qoftë ai.

Në këtë kontekst, duke ia dhënë vetes lirinë - pa ia dhënë kush, ai nuk u struk në mendimin e matur e të druajtur, por foli troç, pra foli hapur e rreptë për të vërtetën.

Ishte një intelektual i deklaruar, që ishte i gatshëm të vdesë për fjalën e lirë dhe këtë e mbronte me mendjen e me gjuhen e vet - shumë të veçantë prej të tjerëve.

Nuk do të ngurronim ta themi se është shembull i njeriut që nganjëherë është kuptuar keq për shkak të të folurit të tij të paskrupullt. Ai na ofron një sintezë të mendimit politik. Si të tillë, na intereson të vështrojmë se çfarë - pikërisht çfarë e bëri Ukshin Hotin të profilit krejt të veçantë nga gjithë e elita e intelektualëve të Kosovës. Ndoshta pse ai nuk e përshtaste dot veten me idenë e mendimit as të urtë, e as finok, por të mendimit që ka mësymjen - jo të revolucionarit, por të intelektualit të pakompromis, duke marrë mbi vete gjithë pasojën.

Liria dhe pavarësia e Kosovës mbeten postulatet e tij të shpallura prej kur e nisi betejën e tij intelektuale dhe mund të thuhet se është emblema e patriotizmit shqiptar të sakrificës, që kurrë më shumë se liria e kombit shqiptar nuk i është dukur e vlefshme.

Liria individuale për të ka qenë veçse një mjet për të punuar e luftuar për lirinë e pavarësinë e Kosovës.

Ukshin Hoti është një autor që spikat në botën ideologjike shqiptare dhe që ngulmoi më se një herë të kthjellojë si qëndrim nacional ëndrrën për Kosovën e pavarur, me kufij shtetërorë të saj. Njeri, jo veç i koncepteve intelektuale, por edhe i ngjarjeve të jetuara, që përbën një mundësi të madhe për ta nxjerrë vlerësimin dhe denoncimin e krimeve të pushtetit serb.

Ai ishte i saktë në terma e koncepte për të kallëzuar se çfarë duan shqiptarët në kuptimin politik, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Është përpjekur aq shumë t'ua shtjellojë miqve, bashkëbiseduesve e lexuesve, pse shqiptarët duhet të jenë të pavarur.

Kur tanimë idetë e tij vijnë duke u parë, të sistemuara në një të vërtetë që ne po jetojmë, ne tashmë e dimë, e kuptojmë se ai e parandjeu dhe e parashikoi në kuptimin historik e politik lirinë e Kosovës.

Për konceptin e Ukshin Hotit është e padenjë që të flasësh e të matesh se çfarë po flet për shkak se mund ta pësoje. Dhe, modeli i këtij intelektual u dha zemër shqiptarëve për të rezistuar, për të mos u nënshtuar.

Ai e kishte shfryrjen origjinale, nuk i dukej kund mllëfi, por rezistenca e fortë. E donte mendimin që zbatohet, që bëhet veprim, për të mos e lënë të degradohet.

Pra, në kuptimin e një sistemi të ndërlidhur të pikëpamjeve, përveç reflektimit teorik e politik, ai mendimin politik e kuptonte si një bazë që shërben për veprim politik.

Gjithmonë mendonte empirikisht me po aq thellësi sa të teorikut e të njohësit të së drejtës ndërkombëtare se çfarë duhet bërë e si duhet të sillemi për t'u çliruar. Vështirë të qëllonte edhe ndonjë i tillë që do ta meritonte të admirohet si ai për fuqinë e mendjes dhe të karakterit. Fismëria e karakterit të tij nuk është vë përballë asnjë kërcënimi apo force.

Virtytet dhe sjelljet e tij ishin fund e krye preokupim mbi ardhmërinë e Kosovës. Është intelektual etik që mbante pozicion kundër ligësisë dhe kundër kompromisit për gjërat që nuk duhet të bëhet asnjëherë kompromis.

Ukshin Hoti më shumë se kushdo tjetër ia dha vlerën që i mungonte intelektualit të druajtur - duke e dhënë modelin e intelektualit të guximshëm.

Ai u bë zëdhënësi i qëndresës dhe i rezistencës ndaj represionit të vazhdueshëm serb, por edhe shpjeguesi racional i pasojave që represioni i zgjatur mund të shkaktonte në të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Në gjyqet serbe, sa herë që atij i ra fati të jetë edhe i akuzuar, edhe avokat i mbrojtjes së vet, ai e ofroi një produkt intelektual e kulturor të njeriut që njeh deri në palcë sistemin e drejtësisë dhe sistemin e represionit e të gjykimeve politike. Duke marrë në shqyrtim mbrojtjen e vet, ai e komprometoi si asnjë tjetër sistemimin gjyqësor serb edhe në kuptimin etik, edhe në atë juridik.

Totalitarizmin komunist sllav, tiraninë e shërbëtorët e tij të zellshëm, ai i denoncoi me gjuhën e tij argumentuese.

Ukshin Hoti ishte një intelektual i çuditshëm, me karakterin e një shqiptari që e ka kulturën dhe aftësinë e tij mendore me dashurinë e madhe për Kosovën dhe reagimin e një burri të madh të Kosovës.

Në këtë rrugë jo të lehtë, më shumë se kushdo tjetër, Ukshin Hoti me veprën dhe jetën e tij është simbol i rezistencës dhe sakrificës, i heroizmit, i trimërisë, i forcës e besimit, përballë dhunës, përballë persekutimit dhe terrorit, prandaj çdo diskutim për të - edhe ky

në Parlamentin e Kosovës, është një respekt për vlerat më të çmueshme të lirisë së Kosovës dhe të intelektualit që u krijua për Kosovën. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të Ukshin Hotit,

Mysafirë të pranishëm,

Qytetarë të nderuar,

Duke e shfrytëzuar këtë rast për këtë mendimtar të madh politik të shekullit XX, kërkoj nga institucionet përkatëse që ta përgatitin për botim, përkthim dhe financim gjithë krijimtarinë e Ukshin Hotit. Kjo do të ishte puna më e mirë në përjetësimin e veprës së ndritur të Ukshin Hotit për sot dhe për nesër.

Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe këtu i mbyllim punimet e kësaj seance.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*